

THE FIGURE OF REPETITION IN THE POEM „PRAYER“ BY MIGJEN AND „ANNABEL LEE“ BY EDGAR ALLAN POE

FIGURA E PËRSËRITJES NË POEZINË „LUTJE“ TË MIGJENIT DHE „ANNABEL LEE“ TË EDGAR ALLAN POE-SË

Erëza RUSHITI

*Corresponding author e-mail: ereza.rushiti1@gmail.com

Abstract

Stylistic figures are frequently present and used in literature, prose and poetry. Expressing our thoughts and feelings in prose and poetry often comes rich and naturally to us. As a stylistic figure of poetic utterance, the figure of repetition serves to reinforce or add to the artistic expression, to emphasise and highlight the emotional or psychological state. As for the organisation of the text, it gives rhythm to the prose and the poem. The purpose of this paper is to present the figure of repetition in two poems: *Annabel Lee* by Edgar Allan Poe and *Lutje* by Migjeni, two outstanding works by outstanding authors and poets from both Albanian and American literature.

The methodology includes a descriptive method for the theoretical framework, and a practical stylistic analysis, where verses are selected and classified according to the type and placement of repetition, presented through tables. The results show that, while Migjeni uses repetition in a more interwoven and powerful way to express inner spiritual revolt, Poe's poem is characterised by five repeated phrases that create a hypnotic and melancholic effect. Although in different linguistic and cultural contexts, the poets use repetition to deepen the emotional message and to communicate with the reader on a more sensitive and universal level.

Keywords: figure, repetition, *Lutje*, *Annabel Lee*, analysis.

Përmbledhje

Figurat stilistike janë të përdorura gjerësisht në letërsi, si në prozë ashtu edhe në poezi. Shprehja e mendimeve dhe ndjenjave tona në këto forma letrare shpesh vjen natyrshëm dhe e pasur. Si figurë stilistike që i përket grupit të figurave të shqiptimit poetik, përsëritja shërben për të theksuar apo përforcuar shprehjen artistike, duke thelluar gjendjen emocionale apo psikologjike që poeti dëshiron të përcjellë. Nga ana strukturore, ajo i jep ritëm si prozës, ashtu edhe poezisë. Qëllimi i këtij punimi ishte të paraqesë figurën e përsëritjes në dy poezi: *Lutje* nga Migjeni dhe *Annabel Lee* nga Edgar Allan Poe, dy vepra të veçanta të krijuara nga autorë të shquar të letërsisë shqiptare dhe asaj amerikane.

Metodologjia përfshin metodën përshkruese për kuadrin teorik dhe një analizë praktike stilistike, ku vargjet janë përzgjedhur dhe klasifikuar sipas llojit dhe vendosjes së përsëritjes, të paraqitura përmes tabelave. Rezultatet tregojnë se, teksa Migjeni e përdor përsëritjen në një mënyrë më të ndërthurur dhe të fuqishme për të shprehur një revoltë të brendshme shpirtërore, poezia e Poe-së karakterizohet nga pesë fraza të përsëritura që krijojnë një efekt hipnotik dhe melankolik. Pavarësisht konteksteve të ndryshme gjuhësore dhe kulturore, të dy poetët e përdorin përsëritjen për të thelluar mesazhin emocional dhe për të komunikuar me lexuesin në një nivel më të ndjeshëm dhe universal.

Fjalët kyçe: figurë, përsëritje, *Lutje*, *Annabel Lee*, analizë.

Hyrje

Letërsia shqiptare dhe ajo botërore kanë pasur përfaqësues të shquar që me veprat e tyre kanë lënë gjurmë të pashlyeshme në historinë e kulturës. Një prej figurave më të rëndësishme të letërsisë shqipe të shekullit të 20-të është Millosh Gjergj Nikolla, i njohur me pseudonimin Migjeni, i cili përmes poezisë dhe prozës së tij shfaq një zë të ri dhe novator. Siç shkruan Bio Shqip (n.d.), Migjeni “për epokën ishte një zë krejtësisht novator nga brendia dhe forma dhe ndikimi mbi letërsinë shqipe të kohës ishte i madh” (parag. 1). Ky ndikim e bën atë një figurë kyçe në zhvillimin e letërsisë shqipe dhe një pikë referimi për studime të mëtejshme mbi stilin dhe temat e saj. Një pjesë të madhe të jetës së tij, poeti ia kushtoi shkrimeve që trajtojnë tema të dhimbshme si varfëria, pabarazia dhe vuajtja njerëzore.

Në thelb të krijimtarisë së tij qëndron dëshira për të ndikuar në ndërgjegjen kolektive të shoqërisë dhe për të sjellë ndryshim përmes fjalës. Në poezinë e tij *Lutje*, poeti i drejtohet Perëndisë në një kërkesë të thellë për gëzim dhe shpirt, duke përdorur gjuhë të thjeshtë por të ngarkuar emocionalisht. Poezia pasqyron një ndjenjë dëshpërimi të brendshëm dhe një kërkesë për shpëtim shpirtëror në një botë të ftohtë dhe të padrejtë. Kjo poezi është një ndër shembujt më të ndjeshëm të revoltës së heshtur dhe kërimit të humanizmit nëpërmjet fjalës poetike.

Në anën tjetër, letërsia amerikane dhe ajo botërore kanë një tjetër emër të shquar, Edgar Allan Poe, i njohur për stilin e tij të veçantë dhe veprat që kanë influencuar letërsinë moderne në mënyrë të thellë. Sipas Poetry Foundation (n.d.-a), Poe “fitoi statusin e një figure kryesore në letërsinë botërore për shkak të tregimeve të tij të shkurtëra të thella, poezive dhe teorive kritike, që vendosën një bazë me ndikim për format e shkurtra në poezi dhe prozë” (parag. 1). Poe krijoi një traditë të veçantë në letërsinë amerikane, ku përmes mjeshtrësisë së tij stilistike arriti të krijojë vepra dhe ndjenja që rezonojnë me lexuesit edhe pas shumë dekadash.

Për poezinë *Annabel Lee*, në një artikull nga Marklong (n.d.) shkruhet, “secila strofë ka një model ndryshe të rimës. Në tërë poezinë ka fjalë të përsëritura si ‘sea, Annabel Lee, and me.’” (parag. 2), gjithashtu diskutohet tematika e poezisë dhe dy personazhet saj, “të dy ishin aq shumë të dashuruar me njëri-tjetrin sa që kjo shkaktoi zili nga vetë qiejt, të cilët i ndëshkuan të dashuruarit me vdekje. Megjithatë, poezia tregon se edhe nëse të dashuruarit ndahen, dashuria e tyre kurrë nuk do të vdesë” (parag. 4). Ky motiv i dashurisë së përjetshme përbën thelbin e poezisë dhe frymëzon lexuesin përmes përsëritjes së elementeve kyçe. Në këtë mënyrë, të dy këta autorë, secili në stilin dhe kulturën e vet, arrijnë të përdorin figurën e përsëritjes për të ndërtuar mesazhe të fuqishme dhe të qëndrueshme që i flasin lexuesit në nivele të ndryshme emocionale dhe intelektuale.

Rishikimi i literaturës

Në këtë kapitull janë trajtuar konceptet kryesore lidhur me stilin dhe figurat stilistike në letërsi, si dhe në veçanti, figurën e përsëritjes, të cilat shërbejnë si themel për analizën e mëtejshme të poezive.

2.1. Disa fjalë mbi stilin: Sipas Solarit (2024), “tërësia e veçorive themelore ideoartistike, e mjeteve dhe e mënyrave të shprehjes në krijimtarinë e një shkrimtari, të një artisti, të një rryme a të një epoke quhet stil” (parag. 1). Stili nuk është vetëm një element statik, por një strukturë dinamike që pasqyron identitetin dhe kontekstin e veprës. Ai formohet nëpërmjet përzgjedhjes së ndërthurjes së mjeteve gjuhësore, të cilat përshtaten me kërkesat dhe natyrën e fushës ku përdoret gjuha. Solari (2024) thekson se “me stil kuptojmë edhe zgjedhjen dhe ndërthurjen e mjeteve të gjuhës sipas kërkesave të një fushe të veprimtarisë” (parag. 1), një qasje që nënvizon rëndësinë e stilit si një mjet që shërben jo vetëm për të shprehur idetë artistike, por edhe për të përshtatur mesazhin në mënyrë efektive ndaj audiencës së synuar.

Për më tepër, studimi i stilit lejon një kuptim më të thellë të ndikimit që mënyra e të shprehurit ka në perceptimin dhe interpretimin e tekstit, duke ndihmuar kështu në analizën e veprave letrare në një nivel më kompleks dhe multidimensional. Siç e shpjegon Solari (2024), “fjala *stil* e ka burimin e vet në fjalën e latinishtes *stilus*, që përdorej për shkophthin me të cilin shkruhej në dërrasat e lyera me dyll, mandej kishte kuptimin e mënyrës së të shkruarit dhe, që kënde, është marrë dhe po përdoret edhe në lëme të tjera” (parag. 9). Ky evolucion i kuptimit reflekton mënyrën sesi termi ‘stil’ është zgjeruar për të përfshirë aspektet teknike dhe dimensionet estetike dhe komunikative të shprehjes. Sot, ‘stil’ nënkupton një sintezë komplekse të elementeve që ndikojnë në mënyrën e perceptimit dhe interpretimit të veprave në fushat më të ndryshme të artit dhe komunikimit.

2.2. *Disa fjalë mbi figurat stilistike*: Në stilistikën letrare, figurat shihen si mjetet më të fuqishme për të shprehur emocionin, mendimin dhe estetikën përmes gjuhës. Zejneli e përkufizon figurën si “çdo shprehje që i jep gjuhës bukuri, kolorit, forcë shprehëse, konkretësi (tropet). Për gjuhën poetike thonë se është gjuhë figurative” dhe shton më tej se figura stilistike konsiderohet “mënyrë jo e rëndomtë e të folurit, që e përdor shkrimtari për ta përforcuar shprehjen dhe fjalën artistike. Figura stilistike janë: inversioni, pyetja retorike, heshtja, paralelizmat, anaforat etj.” (parag. 1-2), duke theksuar se këto mjete gjuhësore kanë vlerë formale dhe mbartin një funksion të rëndësishëm estetik dhe semantik në strukturën e veprës. Krasniqi (2021) beson se figurat stilistike quhen “përdorimet e shprehjeve dhe fjalëve, të cilat, në gjuhën e folur dhe në veprën letrare nuk kanë vetëm kuptimet e zakonshme, të drejtpërdrejta, por sugjerojnë zgjerimin e përdorimit dhe të domethënies të tyre” (parag. 1). Ai nënvizon se një qasje e tillë ndihmon në pasurimin e gjuhës, duke e bërë atë më të pasur në nuanca dhe më të larmishme në shprehje. Gjithashtu, ajo kontribuon në përçimin më të saktë dhe më të thellë të ndjenjave, mendimeve dhe ideve që autori dëshiron të komunikojë tek lexuesi.

Sipas Krasniqi (2021), “stilistika moderne, shprehjet gjuhësore të përdorura me qëllime estetike letrare, i ndanë në dy grupe themelore: figura dhe trope” (parag. 2). Sa u përket figurave stilistike, dallojmë figurat e kuptimit, shqiptimit poetik, fjalëve dhe shprehjeve, fjalorit poetik, dhe figurat e sintaksës poetike. Ndërkaq, në mesin e tropeve dallojmë krahsimin, similitudën, metaforën, katakrezën, metoniminë, sinekdodën, eufemizmin, personifikimin, alegorinë, simbolin, epitetin, antitezën, ironinë, sarkazmën, groteskun, hiperbolë, dhe litotën. Zejneli (2020) poashtu përmend disa nga figurat stilistike, ndër të cilat përfshihen inversioni, pyetja retorike, heshtja, paralelizmat, anaforat, etj.

2.2.1. *Figura e shqiptimit poetik: Përsëritja*: Përsëritja, si figurë e shqiptimit poetik, shpesh shërben si urë lidhëse midis strukturës së gjuhës dhe tensionit emocional të poezisë si dhe një nga mjetet më të fuqishme të ritmit dhe thellimit kuptimor. Terziu (2019) thekson se “përsëritja e një folje, jo thjesht si një veprim, por si një tendosje të kuptimit logjik na pikëlidh me logjikën Hegeliane” (parag. 1), një lidhje kjo që mund të shihet në tre dimensione kryesore: 1) në aspektin e përgjigjes poetike; 2) në pozicionimin e fjalës; në këtë rast të foljes dhe të vargut të mbështetur nga emra dhe mbiemra të përzgjedhur për të përforcuar logjikën e brendshme të tekstit; dhe 3) në ndërtimin e një silogjizmi stilistik, ku përsëritja shërben si hallkë lidhëse mes ideve dhe ndjenjave të shprehura. Sipas Brown (1997), “shpesh përsëritja e saktë e të njëjtës fjale, apo përsëritja e sinonimeve që derivojnë mendime të ngjashme ose edhe të kundërta, shërbejnë për të përcaktuar dhe ndarë narativin në segmente poetike” (f. 189). Përsëritja mund të duket si një mjet i thjeshtë stilistik, por në të vërtetë ajo përfaqëson një strukturë organizative që ndihmon në orientimin e lexuesit dhe në ritmimin e përjetimit letrar.

2.3. *Prezantimi i veprave*: Në këtë pjesë do të prezantohen dy poezitë e autorëve, “Lutje” e Migjenit dhe “Annabel Lee” nga Edgar Allan Poe.

“Lutje” nga Migjeni:

“Të lutem, o perëndi, / për një simfoni / me tinguj t’argjantë / e akorde t’artë. /

Të lutem, o perëndi, / për një simfoni / plot dashuni / të nxehtë si te vasha gjitë / kur vlojnë ndijesitë. /

Të lutem, o perëndi / për një simfoni / të dëfrej në lumni t’u u përkundë n’ani / të bukur t’andrrimeve / të kaltër, ku të fantazmëve / buzët më tërheqin zjarrtë / e më digjen syt e flaktë. /

Të lutem, o perëndi, / për një simfoni / e kurr, e kurr ma mos të zgjohemi.” (Letërsi Shqip, n.d.).

“Annabel Lee” nga Edgar Allan Poe:

“It was many and many a year ago, / In a kingdom by the sea, / That a maiden there lived whom you may know / By the name of Annabel Lee; / And this maiden she lived with no other thought / Than to love and be loved by me. /

I was a child and she was a child, / In this kingdom by the sea, / But we loved with a love that was more than love— / I and my Annabel Lee— / With a love that the wingèd seraphs of Heaven / Coveted her and me. /

And this was the reason that, long ago, / In this kingdom by the sea, / A wind blew out of a cloud, chilling / My beautiful Annabel Lee; / So that her highborn kinsmen came / And bore her away from me, / To shut her up in a sepulchre / In this kingdom by the sea. /

The angels, not half so happy in Heaven, / Went envying her and me— / Yes!—that was the reason (as all men know, / In this kingdom by the sea) / That the wind came out of the cloud by night, / Chilling and killing my Annabel Lee. /

But our love it was stronger by far than the love / Of those who were older than we— / Of many far wiser than we— / And neither the angels in Heaven above / Nor the demons down under the sea / Can ever dissever my soul from the soul / Of the beautiful Annabel Lee; /

For the moon never beams, without bringing me dreams / Of the beautiful Annabel Lee; / And the stars never rise, but I feel the bright eyes / Of the beautiful Annabel Lee; / And so, all the night-tide, I lie down by the side / Of my darling—my darling—my life and my bride, / In her sepulchre there by the sea— / In her tomb by the sounding sea.” (Poetry Foundation, n.d.-b).

Metodat e hulumtimit

Për realizimin e këtij studimi është përdorur qasja dhe metoda kualitative, përmes dy fazave kryesore: analiza teorike dhe analiza praktike. Fillimisht, për pjesën teorike, u aplikua metoda deskriptive me qëllim mbledhjen dhe paraqitjen e literaturës relevante mbi figurat stilistike dhe, në veçanti, mbi figurën e përsëritjes në poezi. Janë konsultuar burime shkencore të ndryshme që trajtojnë ndikimin stilistik dhe funksionin emocional të përsëritjes në tekste letrare. Për pjesën praktike, janë përzgjedhur qëllimisht dy poezi nga autorë të përkatësive të ndryshme kulturore dhe gjuhësore: *Lutje* e Migjenit dhe *Annabel Lee* e Edgar Allan Poe-së. Zgjedhja e këtyre veprave është bërë për shkak të ngjashmërisë në përdorimin e përsëritjes si figurë stilistike kyçe, si dhe për kontrastin që ato ofrojnë në trajtimin e temave emocionale dhe shpirtërore.

Poezitë janë analizuar në aspektin stilistik, me fokus specifik në identifikimin, funksionin dhe ndikimin e përsëritjeve brenda tekstit. Poezitë u ndanë në strofa dhe u analizuan varg për varg për të identifikuar rastet e përsëritjes. Këto raste u sistemuan në tabela ku janë shënuar: strofa, vargu konkret ku ndodhet përsëritja, forma e saj, si dhe funksioni i saj brenda kontekstit poetik. Në çdo rast, përsëritja është shoqëruar me komentim analitik që shpjegon efektin e saj në nivelin stilistik, emocional dhe strukturor të poezisë.

Analiza është zhvilluar duke bërë krahasimin ndërmjet mënyrës së përdorimit të figurës së përsëritjes në të dyja poezitë: tek *Annabel Lee* përsëritja shfaqet si element ritmik e emocional që shërben për të thelluar ndjenjën e humbjes, ndërsa tek *Lutje* ajo shërben si një thirrje e brendshme shpirtërore dhe revoltë sociale. Kësisoj, përmes një strukture të qartë analitike dhe tabelave ilustruese, u mundësua një krahasim i drejtpërdrejtë dhe funksional i figurës së përsëritjes në dy poezi nga dy horizonte të ndryshme letrare.

Rezultatet

Ky kapitull paraqet rezultatet e arritura nga analiza stilistike e figurës së përsëritjes në dy poezitë e përzgjedhura. Analiza i nënshtrohet një qasjeje krahasuese, ku çdo përdorim i përsëritjes komentohet në kontekstin letrar, emocional dhe kulturor të veprës përkatëse.

4.1. *Figura e përsëritjes në poezinë Lutje: Analiza:* Në këtë tabelë janë shënuar vargjet ku shfaqet figura e përsëritjes, së bashku me analizën përkatëse për secilin rast. Tabela shërben si mjet për të ndarë në mënyrë sistematike rastet ku përsëritja luan rol funksional në ndërtimin ritmik dhe emocional të poezisë, si dhe për të përgatitur terrenin për krahasimin që pason.

Tabela 1. Figura e përsëritjes në poezinë *Lutje* e Migjenit

Figura e përsëritjes në vargje:	Analiza:
1. “ Të lutem, o perëndi, / për një simfoni / me tinguj t’argjantë / e akorde t’artë.” (Letërsi Shqip, n.d.).	Poezia hapet me thirrjen “ <i>Të lutem, o perëndi, për një simfoni</i> ”, një kërkesë për një realitet më të bukur përmes muzikës. Vargjet vijojnë me figura që shprehin bukurinë estetike – tinguj të argjenditë dhe akorde të arta – si formë shpëtimi nga realiteti i zymtë.
2. “ Të lutem, o perëndi, / për një simfoni / plot dashuni / të nxehtë si te vasha gjithë / kur vlojnë ndijesitë.” (Letërsi Shqip, n.d.).	Këtu vazhdohet me përsëritje të së njëjtës lutje, këtë herë duke kërkuar një simfoni të mbushur me dashuri, që krahasohet me ndjesitë trupore dhe pasionin e nxehtë. Kjo përsëritje përforcon dëshirën për ndjeshmëri njerëzore në një botë të ftohtë dhe pa shpresë.
3. “ Të lutem, o perëndi / për një simfoni / të dëfrej në lumni t’u u përkundë n’ani / të bukur t’andrrimeve / të kaltër, ku të fantazmëve / buzët më tërheqin zjarrtë / e më digjen syt e flaktë.” (Letërsi Shqip, n.d.).	Në pjesën e tretë thellohet dimensionin i ëndrrës dhe fantazisë, duke shtuar mjete stilistike që sugjerojnë largimin nga realiteti. Fjala kyçe “ <i>andrrimeve</i> ” tregon dëshirën për të jetuar në një botë të krijuar nga imagjinata, ndërsa përsëritja e frazës “ <i>Të lutem, o perëndi...</i> ” ruan vazhdimësinë emocionale.
4. “ Të lutem, o perëndi, / për një simfoni /” (Letërsi Shqip, n.d.).	Edhe në këtë pjesë përsëritet fraza e lutjes. Kjo shërben si kulmim i ndjenjës për nevojën shpirtërore për gëzim, ku poetit i mbetet vetëm lutja si mënyrë për t’i ikur vuajtjes.
5. “ e kurr, e kurr ma mos të zgjohemi.” (Letërsi Shqip, n.d.).	Pjesa apo vargu përmbyllës kërkon që kjo gjendje e ëndërruar të mos marrë fund kurrë. Përsëritja e “ <i>e kurr</i> ” thekson dëshirën për të qëndruar përgjithmonë larg realitetit të ashpër.

Përsëritja në poezinë *Lutje* është jo vetëm mjet stilistik, por edhe thelbi ritmik e emocional i ndërtimit poetik. Ajo përfaqëson një strukturë të vetëdijshme poetike, që i jep poezisë forcë kumtuese dhe një intensitet të theksuar ndjesor. Lutja që përsëritet në fillim të çdo strofe nuk shërben thjesht si frazë hyrëse, por si mjet për të thelluar përshkallëzimin emocional të poezisë, ku dëshirat e poetit rriten dhe bëhen më komplekse në çdo strofë. Zgjedhja për të përsëritur frazën “*Të lutem, o perëndi, / për një simfoni*” krijon një strukturë ciklike që pasqyron gjendjen e pashpresë të individit – një lloj rrethimi emocional, ku dëshira për shpëtim, muzikë, dashuri dhe fantazi mbetet e paqasshme në realitet. Nga vargu në varg, përsëritja përforcon idenë e mungesës së një përgjigjeje nga hyjnorja dhe, për rrjedhojë, përforcon tonin e trishtimit, boshllëkut dhe dëshirës për arratisje.

Në planin kulturor e gjuhësor, gjuha shqipe e Migjenit, e mbushur me ndjeshmëri popullore dhe figura konkrete (si “*tinguj t’argjantë*”, “*te vasha gjitë*”, “*buzët më tërheqin zjarretë*”), e bën përsëritjen jo vetëm një element stilistik, por edhe pjesë të strukturës mendore dhe botëkuptimore shqiptare të kohës. Në këtë kontekst, përsëritja nuk është vetëm një teknikë letrare, por edhe një mjet proteste, një britmë e brendshme që kërkon të dëgjohet dhe të gjejë përgjigje në një botë të shurdhët.

4.2. *Figura e përsëritjes në poezinë Annabel Lee: Analiza:* Më poshtë është paraqitur analiza tabelare që përmbledh vargjet përfaqësuese, ku çdo shembull shoqërohet me analizë përkatëse që interpreton ndikimin e përsëritjes në ndërtimin e mesazhit poetik dhe në formësimin e atmosferës së përgjithshme të veprës.

Tabela 2. Figura e përsëritjes në poezinë *Annabel Lee*

Figura e përsëritjes në vargje:	Analiza:
Strofa e parë: 1. “ I was a child and she was a child , / In this kingdom by the sea,” (Poetry Foundation, n.d.-b).	Në këtë pjesë paraqitet figura e përsëritjes, ku fjalën “ <i>child</i> ” e gjejmë të përsëritur. Folësi, pra autori dhe vajza që ai dashuronte, Annabel Lee, ishin shumë të rinj. Kjo fjalë përsëritet dhe kjo përsëritje thekson faktin mbi moshën e re të të dyve. Përsëritja këtu krijon një efekt ritmik që ngjall një ndjesi pafajësie dhe freskie, e cila është tipike për poezinë romantike dhe sentimentalizmin e periudhës së Poe-së. Në kontekstin gjuhësor anglez, ritmi dhe eufonia që sjell përsëritja është shumë efektive në forcimin e atmosferës së ëmbël dhe nostalgjike.
2. “ But we loved with a love that was more than love — / I and my Annabel Lee— / With a love that the wingèd seraphs of Heaven / Coveted her and me.” (Poetry Foundation, n.d.-b).	Në vargjet “ <i>But we loved with a love that was more than love</i> ” dhe “ <i>With a love that the winged seraph of Heaven</i> ” fjala “ <i>love</i> ” përsëritet katër herë. Autori përdor këtë fjalë katër herë dhe këtu vihet re dhe dhimbja. Nga dashuria e thellë që ndjenin për njëri-tjetrin, ai ndjen dhimbje pasi që nuk e ka më në jetën e tij këtë person kaq të dashur. Ky përdorim i përsëritjes fuqizon emocionin dhe dramatizmin në vargje, duke

	reflektuar ndjenjën e humbjes së thellë romantike që karakterizon poezinë gotike të kohës së Poe-së. Në këtë mënyrë, përsëritja shërben si një mjet që lidh emocionin me strukturën gjuhësore, duke përforcuar temën qendrore të humbjes dhe dashurisë së përjetshme.
3. “It was many and many a year ago, / In a kingdom by the sea, / ... / And this was the reason that, long ago, / In this kingdom by the sea, / ... / To shut her up in a sepulchre / In this kingdom by the sea. / ... / Yes!—that was the reason (as all men know, / In this kingdom by the sea).” (Poetry Foundation, n.d.-b).	Në këto vargje, përsëritja e frazës “in this kingdom by the sea” thekson lidhjen e pazgjidhshme midis vendit dhe kujtimit të dashurisë së humbur të narratorit. Kjo frazë që përsëritet krijon një ndjenjë mitike dhe misterioze për mbretërinë e përshkruar, duke e bërë atë jo vetëm një sfond fizik, por edhe një simbol të pavdekësisë së dashurisë së tyre. Në një kontekst më të gjerë kulturor, kjo përsëritje shpreh edhe lidhjen e fortë të Poe-së me imagjinatën romantike dhe një vizion universal të dashurisë së përjetshme, që shpesh shfaqet në letërsinë anglo-amerikane të shekullit të 19-të. Gjithashtu, ritmi i përsëritur përcjell ndjesinë e një cikli të pafund që përforcon idenë e kohës si një forcë që nuk mund të shlyejë kujtimet dhe ndjenjat.
4. “For the moon never beams, without bringing me dreams / Of the beautiful Annabel Lee; / And the stars never rise, but I feel the bright eyes / Of the beautiful Annabel Lee,” (Poetry Foundation, n.d.-b).	Këtu kemi përsëritjen e frazës “Of the beautiful Annabel Lee”. Poeti sjell detaje tjera rreth tij dhe Annabel Lee-së. Në vargjet 8 dhe 10 të poezisë, ai shprehet se hëna nuk rrezaton pa i sjellë ëndrra “të bukuroshes Annabel Lee,” dhe se yjet nuk ngriten por që ai ndjen sytë e shndritshëm “të bukuroshes Annabel Lee.” Kjo përsëritje jo vetëm e forcon imazhin e Annabel Lee-së, por e ngre atë në një dimension pothuajse hyjnor, duke reflektuar ndikimin e kulturës romantike që shpreh admirimin dhe nderimin për figurën e dashurisë së humbur.
5. “And so, all the night-tide, I lie down by the side / Of my darling—my darling—my life and my bride,” (Poetry Foundation, n.d.-b).	Këtu e kemi të përsëritur frazën “my darling—my darling”. Fjala “darling” përsëritet dy herë. Në këtë përsëritje, me anë të kësaj fjale përkëdhelëse, shprehet sërish dashuria për Annabel Lee-në, njëkohësisht dhe dhimbja e malli për të. Përsëritja e këtij termi të përkëdheljes forcon ndjenjën e intimitetit dhe afërsisë

	së thellë që kishte narratori me të dashurën e tij, duke e bërë dhimbjen më personale dhe të prekshme.
6. “ In her sepulchre there by the sea— / In her tomb by the sounding sea. ” (Poetry Foundation, n.d.-b).	Këtu e kemi përsëritjen frazave “in her” dhe “by the sea” nga dy herë. Tek këto dy vargje të fundit të poezisë, “ <i>In her sepulchre there by the sea— / In her tomb by the sounding sea,</i> ” përsëriten dy frazat e ndryshme, fjalë këto të cilat theksojnë edhe njëherë faktin që Annabel Lee nuk është më. Vdekja dhe mungesa e saj tregohen nëpërmjet këtyre fjalëve, qenien e saj poeti e ndien afër vetes, dhe nga malli që ka për të i qëndron pranë gjithmonë. Përsëritja këtu shërben për të forcuar atmosferën tragjike dhe për të krijuar një lidhje të ngushtë mes lexuesit dhe emocioneve të thella të humbjes.

Poe përdor figurën e përsëritjes për të krijuar një atmosferë të ngadaltë dhe ritmike, që i ngjan një kënge mortore, duke theksuar ndjenja të forta si dashuria, malli dhe dhimbja. Në vargjet: “*But we loved with a love that was more than love*” dhe “*With a love that the winged seraphs of Heaven / Coveted her and me,*” përsëritja e fjalës “love” nuk shërben vetëm për ritëm, por edhe për të ngritur ndjenjën personale në një nivel të shenjtë, duke e paraqitur si dashuri të përjetshme dhe të pakonkurrueshme. Kjo qasje pasqyron frymën e romantizmit amerikan të shekullit të 19-të, ku ndjenja e thellë individuale merr një dimension metafizik dhe poetik.

Po ashtu, fraza “*In this kingdom by the sea*” përsëritet disa herë për të krijuar një hapësirë simbolike ku bashkëjetojnë dashuria dhe vdekja. Ky vend imagjinar nuk është më thjesht një sfond gjeografik, por një mjedis mitik që ruan përjetësisht kujtimin e Annabel Lee-së. Përsëritjet e tjera, si “*Of the beautiful Annabel Lee*” dhe “*my darling—my darling*”, e kthejnë të dashurën në një figurë të idealizuar, që mbetet e gjallë në kujtesën e narratorit. Kështu, përmes përsëritjes, gjuha bëhet mjet për të sfiduar kalueshmërinë dhe për të shprehur një dashuri që i mbijeton kohës dhe humbjes.

Përfundimi

Analiza krahasuese e poezive të Migjenit dhe Poe-së dëshmon se figura e përsëritjes është një ndër mjetet më efektive stilistike për të artikuluar thellësinë e përjetimeve dhe për të ndërtuar ritmin e brendshëm të poezisë. Në poezinë *Lutje*, përsëritja përdoret për të theksuar krizën shpirtërore, ndarjen midis besimit dhe realitetit, si dhe zbrazëtinë përballë mungesës së përgjigjes hyjnore. Përsëritjet në këtë poezi reflektojnë një kërkesë e cila bëhet më shumë se lutje: një nevojë ekzistenciale. Nga ana tjetër, Poe në *Annabel Lee* e përdor përsëritjen për të shtrirë ndjenjën e dashurisë përtej jetës dhe kohës, duke e kthyer kujtimin e të dashurës së humbur në një prani të përhershme.

Ndërkohë që Migjeni përfaqëson një qasje më realiste dhe sfiduese ndaj besimit dhe ekzistencës, Poe ndërton një botë mitike dhe nostalgjike, ku gjuha përsëritëse i jep poezisë një strukturë ciklike dhe meditative. Përsëritja tek Poe jo vetëm që ndihmon në ndërtimin e ritmit të poezisë, por edhe e vendos lexuesin në një gjendje të përhershme reflektimi, duke bërë që vargjet të përsëriten jo vetëm në formë, por edhe në mendjen dhe ndjesinë e lexuesit.

Në të dy rastet, figura e përsëritjes kapërcen kuptimin sipërfaqësor dhe bëhet një formë e shprehjes së thellë psikologjike dhe kulturore—te Migjeni si një përplasje me realitetin e hidhur shqiptar të kohës, te Poe si një sublimim poetik i dhimbjes personale në një kuadër simbolik universal. Poe shfrytëzon elasticitetin e gjuhës angleze dhe traditën romantike për të lartësuar ndjenjat individuale në nivel metafizik, ndërsa Migjeni, i ndikuar nga realiteti social dhe ndikimet e modernizmit evropian, e përdor përsëritjen për të shpalosur tensionet ndërmjet shpirtit dhe strukturave të jashtme ideologjike. Figura e përsëritjes, në të dy poetët, bëhet kështu një urë midis fjalës dhe ndjenjës, ndërmjet lexuesit dhe përjetimit, duke dëshmuar se forca e fjalës së përsëritur është po aq estetike sa edhe emocionale.

References

- [1]. Bio Shqip. (n.d.). Migjeni, Biografia. URL: <https://bioshqip.com/migjeni> (marrë më 2.11.2023)
- [2]. Krasniqi, A. (2021). Figurat stilistike. Prezi.com. URL: <https://prezi.com/p/bg2qleuh8b5s/figurat-stilistike/> (marrë më 2.11.2023)
- [3]. Letërsi Shqip. (n.d.). Lutje. URL: <https://www.teksteshqip.com/migjeni/poezi-100140.php> (marrë më 2.11.2023)
- [4]. Marklong. (n.d.). Annabel Lee, by Edgar Allen Poe. Pressbooks. URL: <https://pressbooks.pub/poetrypoetics/chapter/annabel-lee-by-edgar-allen-poe/> (marrë më 3.11.2024)
- [5]. Poetry Foundation. (n.d.-a). Edgar Allan Poe. URL: Retrieved November 3, 2024, from <https://www.poetryfoundation.org/poets/edgar-allan-poe> (marrë më 3.11.2024)
- [6]. Poetry Foundation (n.d.-b). Annabel Lee by Edgar Allan Poe. URL: <https://www.poetryfoundation.org/poems/44885/annabel-lee> (marrë më 2.11.2023)
- [7]. Solari, M. (2023). Stili dhe Stilistika. ObserverKult. URL: <https://observerkult.com/milivoj-solari-domethenia-e-stilit-eshte-shume-me-e-nderiluar/> (marrë më 2.11.2023)
- [8]. Terziu, F. (2019). Filozofia e përsëritjes, një logjikë Hegeliane në poezi. Fjala e Lirë. URL: <https://www.fjalaelire.com/post/filozofia-e-p%C3%ABrs%C3%ABritjes-nj%C3%AB-logjik%C3%AB-hegeliane-n%C3%AB-poezi> (marrë më 2.11.2023)
- [9]. Zejneli, Xh. (2020). Stilistika dhe metrika (figurat stilistike, rima, strofa, vargu). Bota Sot. URL: <https://www.botasot.info/kultura/1424451/stilistika-dhe-metrika-figurat-stilistike-rima-strofa-vargu/> (marrë më 2.11.2023)